



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Lënda: Procesverbal i mbledhjes 31.01. 2022.

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion për miratim procesverbalin e mbledhjes së datës 31.01. 2022.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në **date 31.01. 2022** në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastrë. Mbledhja po zhvillohet online.

Marrin pjesë në mbledhje 19 anëtarë. Në mbledhje mungojnë Asllan Karagozi , Blerta Karanxha, Kaliopë Rami, Kristi Arapaj, Armand Feruni, Karolina Xheko, Arjan Hasko, Grusilda Cumani, Lorena Gjini, Neim Nebiaj, Zamira Veizaj, Arbora Kore.

Hapet mbledhja nga Z. Lavdi Hasani Është korumi për fillimin e mbledhjes.

Z. Lavdi Hasani Lexohet rendi i ditës.

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 24.12.2021 dhe 19.01.2022
2. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-31.01. 2022**”.
3. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-31.01. 2022**”.
4. P/ Vendim “Për vendosjen në shtëpinë e të moshuarve të Znj. Stavri Bashari”.
5. “Barometri i barazisë gjinore për bashkinë Gjirokastrë”.
6. Të ndryshme

Miratohet rendi I ditës me 19 vota pro.


Kalojmë te miratimi I procesverbalit te mbledhjes së datës 24.12.2021 dhe 19.01.2022.

Miratohet procesverbali me 19 vota pro.

Kalojmë te pika e 2 dhe 3 të rendit të ditës.

1. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-31.01. 2022**”.
2. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-31.01. 2022**”.

Z.Hasani; Keni pyetje për këto dy pika?



Z.Brahimi: A është vënë në zbatim dyfishimi I ndihmës ekonomike?

M.Manxhari: Ligji ka hyrë në fuqi dhe është zbatuar në bazë të ndarjes së kategorive sepse ka familje që përfitojnë 3-fish 2- fish dhe 10% , është vendosur 2-fishi per kategorin e familjeve me 3 femij dhe pjesa tjetër është me 10%.

Z. Hasani: Hedhim në votë piken 2-3.

Miratohen pikat me 19 voto pro.

Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës

P/Vendim “Për vendosjen në shtëpinë e të moshuarve të Znj. Stavrini Bashari”

Z.Zhapa: unë e njoh personalisht personim i cili kërkon të strehohet te shtëpia e të moshuarve dhe jam dakortsisht të përfitoj pasi është në një gjendje shumë të keqe.

Hidhet ne votë pika 4 .

Miratohet me 19 vota pro.

Kalojmë te pika 5. “Barometri i barazisë gjinore për bashkinë Gjirokastër”.

Z.Hasani: Sqarimet për këtë pikë sqarimet do ti japi Z.Rova si kryetare e shoqatës të grave .

Z.Rova : Materialet I keni mar të gjithë me email , ky material ka qënë pjesërisht I vështirë Bashkia Gjirokastër ka promovuar barazine gjinore duke organizuar Workshop ,deklarata ne rjetet sociale , programe të posacme për kujdesin e grave , femijve , grave të dhunuara,viktimave të trafikimit njerzor, gratë shtatzana ,ushqim për foshnjat , familjet e varfëra .

Bashkia Gjirokastër ka vendosur objektiva te ndjeshem por nuk ka njësi performance , nuk ka informacion sa është nr i grave përfituse nga grantet. Bashki Gjirokaster në rastet e diskriminimit nuk ka planifikuar një fond të posacëm .

Nuk kemi informacion si jemi ne në krahasim me 61 bashkitë e tjera, sapo të vijë informacioni brënda muajit shkurt do e shpendajmë dhe te këshilltarët për të parë si jemi me bashkitë e tjera të qarkut .

Z:Hasani: Informacioni nuk qe I plotë por nga një mbledhje e bërë bashkia jonë u vlersua me pikët maksimale me 12 pikë në krahasim me bashkitë e tjera ky është një informacion nga ana ime , nqs ka ndonjë pyetje për këtë pikë.

Kalojmë të pika e te ndryshme , nqs ju keni ndonjë problem , ankesë apo dicka për të thënë .

Për shkak se dhe minutat I kemi të reduktuara këtë pikë do ë shqyrtojmë në mbledhjen e ardhshme dhe pasi këshilltarët nuk kan dicka.

Ather e mbyllim mbledhjen duke i uruar një shërim të shpejt këshilltarëve që sjanë present nga kovidi.

Mbyllet mbledhja në 12:23.

Sekretar i Këshillit

Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT

Laydi HASANI

